



Pranuar / Dorezuar Punimjenol/Prodato Received/Delivery	11.06.2021	1	viti god year
Organ /Njësia Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSACK	3030/2021		114

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A. Nr.308/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.308/2021 të datës 27.04.2021 të parashtruar nga \_\_\_\_\_ nga Prishtina, kundër organit të punësimit Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në çështjen administrative-juridike „Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës“, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 09.06.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A. nr. 308/2021 e datës 27.04.2021, e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi me numër Nr.533 i datës 12.04.2021, i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të Nëpunësve Publikë dhe Ankesave Tjera i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

**A r s y e t i m**

Ankuesi \_\_\_\_\_ i punësuar në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (me tutje MASHTI), me datë 27.04.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2027/2021 të regjistruar me numër A.nr.308/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, për mos zbatim të Vendimit me numër 2-101 të datës 27.01.2021 të u.d Sekretarit të Përgjithshëm të MASHTI dhe Vendimit me numër 533 të datës 12.04.201 të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të Nëpunësve Publikë dhe Ankesave Tjera i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.04.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje

në ankesë të Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Ndërsa Këshilli me datë 03.06.2021, ka pranuar përgjigjen së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën A.nr.308/2021 të datës 27.04.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 30.04.2021; Vendimin e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të nëpunësve publik dhe ankesave tjera i Ministrisë së Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit i datës 12.04.2021; Vendimin me numër 2-101 të datës 27.01.2021; Përshkrimin e Detyrave të Punës; Përgjigjen në ankesë të datës 03.06.2021; Akt Emërimit e datës 04.05.2012; Përshkrimin e Detyrave të Punës; Titujt e vendeve të punës të plotësuar dhe ndryshuar në katalogun e vendeve të punës në shërbimin civil të Kosovës nr.01/2016 të datës 05.02.2016; Procedimi në sistem të pagave i datës 23.11.2017; E-mail nga A.K. për C.Z. i datës 03.06.2021; E-mail nga C.Z. për A.K. i datës 03.06.2021; E-mail nga A.K. për C.Z. i datës 04.06.2021;

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit dhe pas analizimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët, konstatoj se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht sipas Akt Emërimit e datës 04.05.2012, Kolegji ka konstatuar se ankuesi mbanë pozitën e punës Zyrtar i Arsimit të Mesëm të Ulët, në Departamentin e Administratës së Arsimit Para Universitar, pranë Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, me koeficient shtatë (7) të pagës.

Përmes shkresës me numër reference DASHC/MAP-04/530 të datës 23.11.2017, Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil të Ministrisë së Administratës Publike, ka miratuar harmonizimin e koeficientit të pagës për disa tituj të punës në Ministrinë e Arsimit, Shkencë dhe Teknologjisë, në kuadër të të cilëve nuk përfshihet titulli i punës Zyrtar për Arsim të Mesëm të Ulët Parauniversitar.

U.d Sekretari i Përgjithshëm i MASHTI me Vendimin me numër 2-101 të datës 27.01.2021, duke u bazuar në shkresës me numër reference DASHC/MAP-04/530 të datës 23.11.2017, ka aprovuar nivelizimin e koeficientit të pagës për ankuesin nga koeficienti shtatë (7) në tetë (8).

Ankuesi për shkak të mos zbatimit të Vendimit me numër 2-101 të datës 27.01.2021, për nivelizim të koeficientit nga shtatë (7) në tetë (8), me datë 02.04.2021 ushtron ankesë në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave të Nëpunësve Publike dhe Ankesave të Tjera të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Ky i fundit me Vendimin me numër protokollit 553 të datës 12.04.2021 ka aprovuar ankesën e ankuesit si të bazuar dhe ka obliguar Njësinë e Personelit që ankuesit ti kompensohet koeficienti i pagesës nga shtatë (7) në tetë(8) dhe atë nga data e lëshimit të Vendimit me numër 2-101 të datës 27.01.2021.

Pas Vendimit me numër protokollit 553 të datës 12.04.2021 të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të Nëpunësve Publike dhe Ankesave të Tjera, ankuesi me datë 27.04.2021 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të mos zbatimit të Vendimit me numër 2-101 të datës 27.01.2021 të u.d Sekretarit të Përgjithshëm dhe Vendimit me numër 533 të datës 12.04.201 të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të Nëpunësve Publikë dhe Ankesave Tjera. Me tej thekson se bazuar në Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, si dhe shkresën me numër referencë DASHC/MAP-04/530 të datës 23.11.2017, ankuesit i është lejuar nivelizimi i koeficientit të pagës nga shtatë (7) në tetë (8).

Lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtares Publik, përkatësisht nenin 19 ku është përcaktuar se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave.* Ndërlidhur me këtë Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil përkatësisht nenin 3 paragrafi 1 ka përcaktuar se: *1.e drejta e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil, ndërsa neni 9 paragrafi 1 i po këtij Ligji përcakton se: Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kantatës së punës, e si rrjedhojë Kolegji ka konstatuar se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësi civil gëzon të drejtën e realizimit të pagës të përcaktuar në aktin e themelimit të marrëdhënies së punës. Mbi këtë bazë ligjore si dhe bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi në Akt Emërtimin e datës 04.05.2012, ka të përcaktuar koeficient shtatë (7) të pagës dhe se i njëjti realizon koeficient shtatë (7) të pagës.*

Ndërsa, përkitazi me pretendimin ankimor për ngritje të koeficientit të pagës nga shtatë (7) në tetë (8), Kolegji ju referua dispozitave ligjore të nenit 7 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, e me të cilin shprehimisht është përcaktuar se: *1. Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitive në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. 2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore rrjedhë se çdo procedurë e harmonizimit të koeficientit të pagës, duhet të jetë në pajtim me kërkesat ligjore si me lartë gjegjësisht kërkohet miratimi paraprak nga Ministria gjegjëse për administratë publike edhe planifikimi buxhetor i aprovuar nga Ministria përgjegjëse e Financave.*

Bazuar në këtë konstatim, si dhe duke marr parasysh se asnjëra nga veprimet paraprake si me lartë, nuk është ndërmarrë me rastin e nivelizimit të koeficient të pagës së ankuesit nga shtatë (7) në tetë (8) sipas Vendimit me numër 2-101 të datës 27.01.2021 të U.d Sekretarit të Përgjithshëm, Kolegji vlerëson se pretendimet ankimore të ankuesit në këtë kuptim janë të pa bazuara.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtares Publikë (i zbatueshëm nga data 09.07.2020) përkatësisht neni 24 paragrafi 3 i cili përcakton se: *Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji...*Kolegji konstaton se organ i vetëm kompetent për të shqyrtuar ankesat e nëpunësve civil është Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Andaj, në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nen paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, një akt i nxjerrë nga organi i cili nuk ka pas kompetencë, konsiderohet akt i paligjshëm, e mbi këtë bazë ligjore Kolegji vendosi si në pikën II të dispozitiv të këtij vendimi.

Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda A. nr. 308/2021

**Çlirim Zeka**

*Zeka*  
Procesmbajtës

**Ardita Haxhnikaj Demi**

*Ardita Haxhnikaj Demi*  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- *Ankuesit*
- *Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;*
- *Udhëheqësit të Personelit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*